

YOUR PARTNER IN
growth
&
transformation

Workshop

Ligji i ri “Për tatimin mbi të ardhurat”

&

Paketa fiskale 2024

BINVEST
360° CONSULTING SERVICES



Agenda

- **Ligji dhe Udhëzimi “Për Tatimin mbi të Ardhurat”**
- **Paketa fiskale 2024- ndryshimet**
- **Pyetje & përgjigje**

Ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” Udhëzimi “Për Tatimin mbi të Ardhurat”

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Panoramë e përgjithshme

- Ligji aktual në fuqi që nga 1999
- Parashikime ligjore jo në linjë me zhvillimet e biznesit/teknologjike
- Boshlliqe ligjore te konsiderueshme
- Ndryshime të shpeshta dhe probleme leximi/interpretimi
- Limitime parashikimesh ne lidhje me tatimin mbi te ardhurat personale
- Perafrimi me Direktivat e BE dhe Udhezuesit e OECD

Ndryshuar me Ligj nr. 9483, datë 16.2.2006, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 20, datë 16.2.2006.
Ndryshuar me Ligj Nr. 9632, datë 30.10.2006, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 123 datë 27.11.2006
Ndryshuar me ligjin nr. 9716 datë 16.04.2007, botuar në fletoren zyrtare Nr. 54 datë 12.05.2006
Ndryshuar me ligj Nr. 9735 datë 17.05.2007, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.63, datë 04.06.2007.
Ndryshuar me ligj nr. 9766 datë 09.07.2007, botuar në fletoren zyrtare Nr. 90 datë 21.07.2007.
Ndryshuar me Ligj nr. 9804 datë 13.09.2007, botuar në fletoren zyrtare Nr.125 datë 27.09.2007.
Ndryshuar me Ligj nr. 9844 datë 17.12.2007, botuar në fletoren zyrtare Nr.180 dhjetor 2007.
Ndryshuar me Ligj nr. 9943, date 26.6.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 114 dt. 22.6.2008.
Ndryshuar me Ligj nr.10072,datë 9.2.2009, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 20, datë 04.03.2009.
Ndryshuar me Ligj nr.10228,datë 4.2.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 13, datë 25.02.2010.
Ndryshuar me Ligj nr.10343,date 28.10.2010,botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.159, date 3.12.2010.
Ndryshuar me Ligj nr. 10364, date 16.12.2010, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 179, dhjetor 2010.
Ndryshuar me Ligj Nr. 20/2012, date 1.3.2012, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 26, date 27 mars 2012.
Ndryshuar me Ligj nr. 71/2012, date 28.6.2012, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 89, date 31 korrik 2012.
Ndryshuar me Ligj Nr. 122/2012, date 20.12.2012, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr, 177, data 09.01.2013
Ndryshuar me Ligj Nr. 107/2013, date 28.3.2013, botuar ne FL.Z. 53, date 15 prill 2013.
Ndryshuar me Ligj nr. 124/2013, date 25.4.2013, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 76, date 9.05.2013.
Ndryshuar me Ligj Nr. 177/2013, datë 28.12.2013, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013.
Ndryshuar me Ligj Nr. 32/2014, datë 3.4.2014, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 57, datë 24 prill 2014.
Ndryshuar me Ligj Nr. 42/2014, datë 24.4.2014, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 70, datë 20 maj 2014.
Ndryshuar me Ligj Nr.83/2014, datë 17.07.2014,botuar në Fletoren Zyrtare Nr.126, datë 11.08.2014.
Ndryshuar me Ligj nr. 156/2014, dt. 27.11.2014. Botuar në FL.Z. nr. 195, dt. 24 dhjetor 2014.
Ndryshuar me Ligj 129/2016, datë 15.12.2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr.259, datë 06.01.2017
Ndryshuar me Ligj nr. 105/2017, dt. 30.11.2017. Botuar në FL.Z. nr. 222, dt. 19 dhjetor 2017.
Ndryshuar me Ligj nr. 39/2018, dt. 09.07.2018. Botuar në FL.Z. nr. 134, dt. 18 shtator 2018.
Ndryshuar me Ligj nr. 94/2018, dt. 03.12.2018 Botuar në FL.Z. nr. 183, dt. 21.12.2018.
Ndryshuar me Aktin Normativ nr. 5, dt. 30.11.2019, Botuar në FL.Z. nr. 162, dt. 02.12.2019, miratuar me Ligjin nr. 79/2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, datë 16.12.2019.
Ndryshuar me Aktin Normativ nr. 10, dt. 18.12.2019, Botuar në FL.Z. nr. 173, dt. 18.12.2019.
Ndryshuar me Ligj nr. 84/2019 dt. 18.12.2019. Botuar në FL.Z. Nr. 184, dt. 31.12.2019
Ndryshuar me Aktin Normativ Nr. Nr.10, datë 26.3.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 52, datë 26.03.2020.
Ndryshuar me Aktin Normativ Nr.18, datë 23.04.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 73, datë 24.04.2020.
Ndryshuar me Ligj Nr. 106/2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 154, datë 26.08.2020.
Ndryshuar me Ligj Nr. 107/2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 154, datë 26.08.2020.
Ndryshuar me Ligj Nr. 163/2020, datë 23.12.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 11, datë 21.01.2021
Ndryshuar me Akt Normativ Nr. 20, datë 05.05.2021, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 68, datë 07.05.2021
Ndryshuar me Ligj Nr. 113/2021, datë 25.12.2021, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 17.12.2021
Ndryshuar me Akt Normativ Nr. 4, datë 12.03.2022, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 40, datë 14.03.2022

Fusha e zbatimit

Tatimi mbi të ardhurat e korporatave

- Entitetet e krijuar sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, apo ligjeve të veçanta;
- Shoqëritë e thjeshta sipas parashikimeve në Kodin Civil (joint ventures);
- Çdo entitet tjetër, përfshirë entitetet jorezidente, që krijojnë **seli të përhershme** në Shqipëri (në formën e degës apo çdo forme tjetër).



1. Nje dege, vend administrimi, fabrike, punishte, miniere, pus nafte ose gazi.
2. Projekt ndërtimi, montimi dhe projekte të lidhura me to – nëse projekt zgjat për një periudhë prej më shumë se **6 muajsh** gjatë çdo periudhe 12 mujore;
3. çdo aktivitet në lidhje me kërkimin, nxjerrjen ose shfrytëzimin e burimeve natyrore – nëse zgjat për një periudhë prej më shumë se **3 muajsh** gjatë çdo periudhe 12 mujore;
4. kryerja e shërbimeve - për një periudhë ose periudha në total prej më shumë se **6 muajsh** gjatë çdo periudhe 12 mujore.

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjet për Eleminimin e Taksimit të Dyfishtë.

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Rezidenca

Subjektet rezidente në Republikën e Shqipërisë taten në Shqipëri për të ardhurat e realizuara në të gjithë botën.

Ishte:

Konsiderohet rezident në Shqipëri personi juridik, i cili:

- Ka selinë qendrore në Republikën e Shqipërisë;
- Ka vendin e menaxhimit efektiv të biznesit në Republikën e Shqipërisë.

Bëhet:

Konsiderohet rezident në Shqipëri një subjekt:


- Nëse **është themeluar** në Shqipëri;
- Nëse ka vendin e **menaxhimit** dhe **kontrollit efektiv** në Republikën e Shqipërisë.

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Saktësime në lidhje me llogaritjen e tatimit (në rast rezultati pozitiv)

Tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e korporatave llogaritet duke aplikuar normat e tatimit mbi të ardhurat e korporatave, dhe duke zbritur:

1. kreditimin e tatimit të huaj;
 2. tatimin e mbajtur në burim;
 3. paradhëniet për tatimin mbi të ardhurat të paguara gjatë vitit tatimor.
- Nëse diferenca është negative, tatimpaguesi mund të kërkojë tatimin e tepërt dhe kjo shumë duhet të kthehet jo më vonë se 60 ditë nga data e aplikimit.
 - Mund të mbartet dhe në vitin pasardhës.



Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Saktësime në lidhje me llogaritjen e tatimit (në rast rezultati negativ)

Ishte:

- Humbjet nga veprimtaria ekonomike mbarten për 3 vjet.
- Nuk lejohet mbartja e humbjeve kur ndryshon pronësia më shumë se 50%.

Bëhet:

- Humbjet nga veprimtaria ekonomike mbarten **për 5 vjet.**
- Nuk lejohet mbartja e humbjeve kur ndryshon pronësia më shumë se 50%, por vetëm nëse ndryshon dhe lloji i veprimtarisë së tatimpaguesit.

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Saktësime në lidhje me rregullat e ndryshimit të pronësisë

Ishte:

Nëse tatimpaguesi:

1. I ndryshohet pronësia me më shumë se 20%; dhe
2. për tre vitet paraardhëse, ka realizuar një mesatare qarkullimi prej 500,000,000 (pesëqind milionë) lekësh.

Tatimpaguesi trajtohet si:

- a) përfitues i të ardhurave nga shitja, e barabartë kjo me pjesën proporcionale të vlerës së tregut të aktivit në atë kohë; dhe
- b) riblerës i aktivit për të njëjtën vlerë.


Bëhet:

Rregullat e ligjit të vjetër qëndrojnë vetëm për sektorët sa më poshtë:

- Entitetet që zotërojnë të drejta për shfrytëzimin e **pasurive minerale, hidrokarbure dhe burimeve natyrore, tokësore dhe ujore;**
- Entitetet që ushtrojnë veprimtari në fushën e **telekomunikacioneve;**
- Entitetet që ushtrojnë veprimtari si **institucione financiare.**

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Rikujtesë llogaritja e tatim fitimit



Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Shpenzimet jo të zbritshme dhe kufizimi i zbritjes

- Shpenzimet për shërbime teknike, konsulencë dhe menaxhim të faturuara nga jorezident të pagueshme brenda periudhës së deklaratës (31 mars);
- Heqja e limitimit për shpenzimet e dietave; limitime të akomodimit (brenda vendi, deri 6.000 lekë dita dhe jashtë vendit deri 150 euro dita) limitime të dietave ushqimor (4.000 lekë dita/ 80 euro dita) limitime për udhëtim brenda vendi (çmimi i biletave interurban të miratuara për transportin publik);
- Interesi është i zbritshëm deri në masën e 30% të EBITDA për çdo lloj EBITDA (nuk aplikohet me raporti 4:1 i kapitalit);
- Shpenzimet e sigurimit të jetës dhe shëndetit të punonjësve të tatimpaguesit që tejkalojnë 5% të pagave bruto të tyre për vitin tatimor;
- Shpenzimet e kryera si konsum personal nga aksionarët, ortakët, administratorët dhe familjarët e tyre;
- Rryshfetet;
- Shpenzimet që nuk lidhen me të ardhura të përfshira në të ardhurat e tatueshme;

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Amortizimi

Ishte:

Klasa e aktivit	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa, instalime dhe ndërtime me një jetë të dobishme prej më shumë se 20 vjetësh	Metoda e vlerës së mbetur	5%
Aktive jo të trupëzuara	Metoda lineare	15%
Kompjuterat, sistemet e informacionit, produktet e programeve kompjuterike (softëare) dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave	Metoda e vlerës së mbetur	25%
Të gjithë aktivet e tjerë	Metoda e vlerës së mbetur	20%

Bëhet:

Klasa e aktivit	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa, instalime dhe ndërtime me një jetë të dobishme prej më shumë se 15 vjetësh	Metoda lineare	5%
Aktive jo të trupëzuara	Metoda lineare	15%
Kompjuterat, sistemet e informacionit, produktet e programeve kompjuterike (softëare) dhe pajisjet e ruajtjes së të dhënave	Metoda lineare	25%
Të gjithë aktivet e tjerë	Metoda lineare	20%

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Amortizimi (vazhdim)

- Baza e amortizimit për autoveturat 1+4 të personelit nuk mund të jetë më e lartë se 50% e kostove të blerjes dhe rikonstruksionit. Kostoja **e plotë** e autoveturës 1+4, e cila amortizohet 50%, nuk mund të jetë më e lartë se **10 000 000 lekë**.
- Në rastin kur baza e amortizimit nuk kalon 10 000 lekë, e gjithë baza e amortizimit do të konsiderohet një shpenzim i zbritshëm (limiti 5 000 lekë në ligjin aktual).
- Nëse një aktiv del jashtë përdorimit gjatë një viti tatimor, vlera kontabël e mbetur për qëllime tatimore është e zbritshme në atë vit, me kusht që të ardhurat e mundshme nga nxjerrja jashtë përdorimit të jenë përfshirë në fitimin e tatueshëm.
- Rivlerësimet e çdo kategorie të aktiveve afatgjata të biznesit për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, nuk merren në konsideratë për efekt të bazës mbi të cilin llogaritet amortizimi.

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Inventari

Ishte:

Njohja fillestare (me kosto) dhe vlerësimi i inventarit, në fund të periudhës tatimore, bëhen sipas metodave të përcaktuara në ligj.

Bëhet:

- Për vlerësimin e inventarëve, tatimpaguesi mund të përdorë cilëndo nga metodat e vlerësimit të parashikuara nga legjislacioni, e cila duhet të përdoret për jo më pak se 5 vjet.
- Inventari i imët amortizohet në masën 50% në vitin e blerjes së tij dhe në masën 50% në vitin pasardhës.
- Zhvlerësimi dhe rivlerësimi i inventarit, pas njohjes fillestare, nuk njihen për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm.

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Provizjonet dhe zbritja e borxhit të keq

Ishte:

Borxhi i keq njihet si shpenzim i zbritshëm, në rast se plotësohen, njëkohësisht, tri kushtet e mëposhtme:

- Një shumë, që korrespondon me këtë borxh, është përfshirë më parë në të ardhurat;
- Borxhi është fshirë nga librat kontabël të tatimpaguesit;
- Janë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore për arkëtimin e tij (vendim i formës së prere të Gjykatës).

Bëhet:

Zbritja lejohet:

- deri në 20% të borxhit të keq, kur është i papagueshëm për më shumë se 6 muaj;
- deri në 40% të borxhit të keq, kur është i papagueshëm për më shumë se 12 muaj;
- deri në 60% të borxhit të keq, kur është i papagueshëm për më shumë se 24 muaj;
- deri në 85% të borxhit të keq, kur i papagueshëm për më shumë se 36 muaj.

Zbritja e plotë e borxhit të keq lejohet nëse njëkohësisht plotësohen kushtet e mëposhtme:

- borxhi i keq, i përfshirë më parë në të ardhurat, hiqet nga librat kontabël, dhe
- tatimpaguesi ka ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm ligjorë për mbledhjen e borxhit të keq.

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Specifika të reja në lidhje me tatimin në burim

Ishte:

- Mbajtja e tatimit në burim për pagesat rezident me jo rezident;
- Mbajtja e tatimit në burim për pagesat rezident me persona të peregjistruar.

Bëhet:

- Mbajtja e tatimit në burim për pagesat rezident me jo rezident.
- Mbajtja e tatimit në burim për pagesat rezident me persona të peregjistruar.
- **Mbajtja e tatimit në burim rezident me rezident për pagesat e disa kategorive të dividendëve, interesave, honorareve, të ardhurat nga lojërat e fatit.**

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Specifika të reja në lidhje me tatimin në burim

Lloji i të ardhurave	I nënshtrohet tatimit në burim nëse i paguhet një rezidenti ose një jorezidenti me seli të përhershme në Shqipëri	Norma e tatimit në burim
Dividendët	Po, vetëm në rast pjesëmarrje 10% në 24 muaj	8%
Interesat	Po	15%
Honoraret	Po	15%
Qiratë	Po, vetëm kur paguhet për individë	15%
Shërbimet dhe llojet e tjera të të ardhurave	Po, vetëm kur paguhet për individë	15%

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Specifikime/ Koncepte të reja

- Kontratë afatgjatë (mbi 12 muaj) - Shpenzimet në kontrata të tilla duhet të njihen në periudhën kur kryhen, ndërsa të ardhurat i korrespondojnë pjesës së kontratës së përfunduar në vitin tatimor përkatës.
- Ri-organizimi i bizneseve rezidente në Shqipëri të tilla si bashkimet, transferimet e aktivitetit, ndarjet, ndarjet e pjeshme, shkëmbimi i aksioneve dhe transferimet e degëve të veprimtarisë nuk është subjekt tatimi.
- Prezantimi i konceptit të “Exit Tax” në rastin e transferimit të aktivitetit jashtë Shqipërisë (diferenca midis vlerës së tregut dhe vlerës së asetit në momentin që lë Shqipërinë).


Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Çfarë do të ndodhë me lehtësirat në fuqi?

Sektori/ Tatimpaguesi	Norma e tatimit	Data e aplikimit të tarifës
Prodhimi ose zhvillimi i softuerit nga personat juridik	5%	31 dhjetor 2025
Entitetet me të ardhura bruto deri 14 milionë lekë në vit (me përjashtim të shërbimeve profesionale)	0%	31 dhjetor 2029
Entitetet që zhvillojnë veprimtari ekonomike “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”	5%	31 dhjetor 2029
Entitetet që operojnë në struktura akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”	0%	Për një periudhë 10-vjeçare duke filluar nga fillimi i aktivitetit, por jo më vonë se tre vjet nga data e marrjes së statusit special (që duhet të ndodhë brenda datës 31 dhjetor 2024)
Agroturizmi	5%	31 dhjetor 2029
Industria automotive	5%	31 dhjetor 2029

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat personale

Llojet e tatimit mbi të ardhurat



Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat personale

Të ardhurat të përjashtuara nga Tatimi mbi Të Ardhurat Personale

Të ardhurat e përfituara nga sigurimi i detyruar në skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Ndihmat ekonomike nga buxhetet publike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta

Të ardhurat e përjashtuara në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi

Kompensimet financiare të paguara si shpërblim për shpronësimet e bëra

Kompensimet financiare të paguara ish-të dënuarve politikë

Shpërblimet nga institucionet shtetërore për arritje në shkencë, sport, kulturë

Bursat e nxënësve dhe të studentëve

Dëmshpërblimet nga vendimet e formës së prerë të gjykatave, si dhe kostot gjyqësore

Dëmshpërblimet nga kontratat e sigurimit


Të ardhurat nga mbështetja me grante dhe subvencione në bujqësi dhe blegtori

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat personale

Fusha e zbatimit e ardhurave personale

Tatimpagues rezident i tatimit mbi të ardhurat personale është çdo tatimpagues që përmbush **një prej kushteve** të mëposhtme:


- ka një vendbanim të qëndrueshëm në territorin e RSH;
- qëndron në RSH për periudha që në total arrijnë të paktën 183 ditë;
- është shtetas i RSH, i punësuar jashtë shtetit nga qeveria e Shqipërisë;
- ka një vend fiks ku zhvillon aktivitet biznesi ose ka vendbanim të zakonshëm në RSH, përveç rastit kur personi fizik ka një banesë të përhershme jashtë RSH për të gjithë vitin tatimor dhe gjithashtu nuk ka banesë të përhershme në RSH;
- ka qendrën e interesave jetike në RSH;



Kujdes: Një prej kushteve mjafton të përmbushet.


Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat personale

Kategoritë e të ardhurave personale




Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat personale

Shkalla tatimore për Tatimin mbi të Ardhurat Personale




Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat personale

Taksimi i të Ardhurave Personale nga Biznesi



Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat personale

Taksimi i të Ardhurave Personale nga Punësimi



Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Koncepte të reja

Punëdhënësi



- Mbajtja e tatimit në burim nga të ardhurat nga punësimi
- Dorëzimi i listëpagesës
- Transferimi i tatimit të mbajtur në thesar


Agjenti tatimor i listëpagesës



- Mbajtja e tatimit sipas shkallës progresive të tatimit nëse tatimpaguesi i të ardhurave personale nënshkruan deklaratën mbi statusin personal
- 15% të pagesës për rastet e tjera dhe që jo në marrëdhënie punësimi
- Duhet të marrë në konsideratë në baza mujore 1/12 e zbritjeve nga baza e tatimit kur llogarit TAP
- Kur PM është i punësuar në një punë tjetër aplikohet shkalla progresive e tatimit, por jo zbritja
- Përgjegjës për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi me të njëjtën përgjegjësi sikur ai të ishte borxhi i tyre tatimor

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat e korporatave

Koncepte të reja



Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat personale

Tatimi i trashëgimisë, dhuratave dhe fitimeve nga lojërat e fatit

Kategoritë dhe mekanizmat e tatimit të trashëgimisë, dhuratave dhe fitimeve nga lojërat e fatit janë:

rezidentët në RSH, të cilët marrin një dhuratë ose trashëgimi të aseteve të ndodhura në Shqipëri ose jashtë saj, ose marrin fitime nga lojërat e fatit të zhvilluara në RSH ose jashtë saj;

jorezidentët në RSH, që marrin një dhuratë ose trashëgimi të aseteve të ndodhura në Shqipëri, ose marrin fitime nga lojërat e fatit të zhvilluara në Shqipëri.

15% (pa
zbritjen e
ndonjë
kostoje)

Ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat personale

Tatimi i trashëgimisë, dhuratave dhe fitimeve nga lojërat e fatit

Përfshihen nga tatimi:

- dhurimet dhe trashëgimia e përfituar nga/ose ndërmjet trashëgimtarëve ligjorë në radhë të parë dhe të dytë, si dhe dhurimet dhe trashëgimia brenda lidhjes gjinore motër-vëlla;
- dhurimet dhe trashëgimitë të marra përveç atyre të përcaktuara në shkronjën “a” deri në 5 000 000 lekë për tatimpagues për pasuritë e paluajtshme dhe deri në 1 000 000 lekë për pasuritë e luajtshme për tatimpagues;
- kalimi i së drejtës së pronësisë trashëgimtarëve ligjorë, përkatësisht nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur prona rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme.

Paketa fiskale 2024

Ndryshimet që priten

Paketa fiskale 2024

Ndryshimet e pritshme

- Ashpersohen gjobat ne rast te mos-leshimit te faturave (shkelje per here te dyte)

Gjobë prej 50 000 lekësh për tatimpaguesit e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi, gjobë 100 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi apo vetëpunësimi me TVSH-në, gjobë 500 000 lekë për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin korporativ.

- Ndryshon taksa e karbonit e aplikueshme mbi qymyrin ne 3.5 leke/ kg ne 2024.

- Hiqet TVSH në import për importimin e mëshqerrave dhe insekteve (përfshirë bletët) sipas nomenklaturës përkatëse.

- Në vitin 2024, akciza për karburantin, për pijet alkoolike, për kafen apo për produktet energjetike kufizohet në vetëm 1.5% (ne 2021 ishte vendosur që rritja do të ishte sa shuma e inflacionit e dy viteve të fundit).

Pyetje dhe përgjigje